

LIGJI NR. 03/L-037

PËR DOKUMENTET E UDHËTIMIT

Në mbështetje të Kapitullit IV neni 65 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJIN PËR DOKUMENTET E UDHËTIMIT

**KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky ligj përcakton rregullat ligjore, kuptimin, përmbajtjen, procedurat, mënyrën e aplikimit për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit, llojet e dokumenteve të udhëtimit dhe vlefshmërinë e tyre për shtetasit e Republikës së Kosovës.

**Neni 2
Përkufizimet**

Nocionet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

- “**Pasaporta**”- është dokument publik i udhëtimit që i shërben shtetasit për kalimin e kufijve shtetëror;
- “**Pasaportë diplomatike**” - është dokument udhëtimit që u jepet përfaqësuesve të misionëve diplomatike dhe personelit diplomatik si dhe zyrtarëve të tjerë të përcaktuar nga ky ligj;
- “**Pasaporta zyrtare**” - është dokument udhëtimit që u jepet personelit teknik dhe administrativ të misionëve diplomatike në Ambasada dhe Konsullata si dhe zyrtarëve të tjerë të përcaktuar nga ky ligj;
- “**Fletudhëtimi**” - është dokument udhëtimit që u lëshohet shtetasve jashtë shtetit që kanë humbur, i është vjedhur apo i ka kaluar afati i vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit;
- “**Dokument udhëtimit grupor**”- është dokument udhëtimit që u jepet grupeve të ndryshme kur ata udhëtojnë në grup;
- “**Të dhëna biometrike**” - janë të dhëna unike, dhe paraqesin karakteristikat fizike të individit të cilat shërbejnë për të përcaktuar identitetin nëpërmjet pamjes së fytyrës, shenjave të gishtërinjve dhe bebëzave të syrit;
- “**Shtetasi**” - është çdo person i cili e ka shtetësinë e Republikës së Kosovës në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi;
- “**Ministria**” – do të thotë Ministria e Punëve të Brendshme;
- “**Të dhënat personale**” – nënkuptojmë emrin personal, datën e lindjes, numrin personal, gjinia dhe vendi i lindjes.

Neni 3

Pasaporta është dokument publik, që i jepet shtetasit të Republikës së Kosovës (në vazhdim të tekstit: shtetasi) për kalimin e kufijve shtetëror dhe për vërtetimin e identitetit dhe shtetësisë.

Neni 4

Shtetasi ka të drejtë të ketë vetëm një dokument udhëtimi të llojit të njëjtë, përjashtimisht në rastet e përcaktuara nga organi kompetent.

Neni 5

5.1 Shtetasi është i detyruar të ketë me vete dokumentin e udhëtimit të vlefshëm, me anë të së cilës ai mund të dalë e të hyjë nga dhe në territorin e Republikës së Kosovës, si dhe të udhëtojë nga një shtet i huaj në një tjetër, nëse me marrëveshje ndërkombëtare nuk është caktuar ndryshe.

5.2 Autoriteti kompetent për kontrollimin e kalimit kufitar, do të lejojë hyrjen në Republikën e Kosovës të shtetasit të vet, i cili nuk ka pasaportë të vlefshme udhëtimi, në qoftë se shtetësia dhe identiteti i tij nuk vihen në dyshim.

Neni 6

Është e ndaluar që shtetasi ta shesë, ta japë, ta huazoj dokumentin e tij të udhëtimit, respektivisht ta blejë, ta përvetësojë, apo ta përdorë dokumentin e huaj të udhëtimit me qëllim të realizimit të ndonjë përfitimi ose të drejte, si dhe të ndryshojë, shlyej çfarëdo të dhëne në dokumentin e udhëtimit.

KREU II

LLOJET E DOKUMENTEVE TE UDHËTIMIT DHE KOMPETENCA PËR LËSHIMIN E TYRE

Neni 7

Dokumentet e udhëtimit janë:

- a) pasaporta;
- b) pasaporta diplomatike;
- c) pasaporta zyrtare;
- d) fletudhëtimi- dokument udhëtimi për kthim;
- e) dokument udhëtimi grupor;
- f) dokumentet e udhëtimit, që lëshohen me marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 8

8.1 Organi kompetent për dhënien e pasaportës dhe të dokumentit të udhëtimit grupor, është Ministria e Punëve të Brendshme (në vazhdim të tekstit: Ministria).

8.2 Në rastet urgjente: shërim, sëmundje dhe vdekje të anëtarit të ngushtë të familjes, punët urgjente zyrtare dhe ato të biznesit, Ministria mund të lëshojë pasaportë me procedurë të shpejtë.

8.3 Për shtetasin që jeton përkohësisht jashtë shtetit dhe për shkaqe shëndetësore apo shkaqe të tjera të arsyeshme nuk mund të kthehet në shtetin amë, mund ta lëshojë pasaportën edhe organi kompetent jashtë shtetit për kryerjen e punëve në përfaqësitë diplomatike konzulare.

8.4 Pasaportën diplomatike dhe pasaportën zyrtare e lëshon Ministria për Punët e Jashtme.

8.5 Dokumentet e udhëtimit për kthim i lëshon organi kompetent jashtë shtetit që është i autorizuar për kryerjen e shërbimeve dhe punëve në përfaqësitë e misionit diplomatik konzular.

Neni 9

9.1 Shtetasi më i ri se 14 vjet (në vazhdim të tekstit: fëmija) mund të udhëtojë jashtë shtetit me përcjellje të prindërve, përfaqësuesit ligjor, apo me leje të tyre nga ndonjë person tjetër.

9.2 Në rastet e arsyeshme, kur fëmija është dhënë për kujdesje familjeve kujdestar, apo kur përfaqësuesi ligjor nuk është i arritshëm, për shkak të sigurisë dhe interesit të fëmijës, lejen e lëshon qendra kompetente për punë sociale.

9.3 Leja nga paragrafi 2 i këtij neni lëshohet në formularin që përmban të dhënat nga pikat a,b,c, dhe d, të nenit 23 paragrafi 2 të këtij ligji si dhe numrin serik të dokumentit të udhëtimit të fëmijës dhe të personit me të cilin fëmija udhëton jashtë shtetit apo të vijë nga jashtë në Republikën e Kosovës.

9.4 Lejen nga paragrafi 3 i këtij neni e aprovon Ministria, apo organi kompetent, që është i autorizuar për kryerjen e punëve të shërbimit konsullor.

9.5 Të dhënat nga paragrafi 3 i këtij neni, organet nga paragrafi 4 i këtij neni, mund të shfrytëzojë edhe nga evidenca sipas nenit 31 të këtij ligji.

Neni 10

10.1 Pasaporta diplomatike i lëshohet: Kryetarit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kryeministrit dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Avokatit të Popullit, punëtorëve të përfaqësive diplomatike dhe konsullore si dhe misioneve të Republikës së Kosovës jashtë shtetit, që kanë emërimet diplomatike, shërbimeve konsullore, si dhe punëtorëve të ministrisë për punët e jashtme, që kryejnë punët diplomatike dhe konsullore dhe kanë emërimet diplomatike, prijësit të delegacioneve shtetërore të Republikës së Kosovës, personave që me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës shkojnë për punë në organizatat ndërkombëtare si funksionarë të rangut diplomatik në organizatat e përmendura, korrierëve diplomatik dhe personave të tjerë të caktuar, nëse kjo është në interes të Republikës së Kosovës.

10.2 Pasaporta diplomatike mund t'i lëshohet edhe anëtarit të ngushtë të familjes të punëtorëve të përfaqësive diplomatike dhe konsullore të misioneve të Republikës së Kosovës jashtë shtetit dhe anëtarëve të familjes të personit, që me vendimin e qeverisë shkojnë për punë në organizatat ndërkombëtare, nëse me ta jetojnë në bashkësi familjare të përbashkët jashtë shtetit, si dhe anëtarit të ngushtë të familjes të personit nga paragrafi 1 i cili e shoqëron në udhëtimin zyrtarë jashtë shtetit.

Neni 11

11.1 Pasaportë zyrtare i lëshohet stafit politik të shtetit të Republikës së Kosovës, punëtorit të Ministrisë për Punët e Jashtme dhe punëtorit të punësuar në përfaqësitë diplomatike apo konzulare të Republikës së Kosovës jashtë shtetit, që nuk kanë pasaportë diplomatike.

11.2 Pasaportë zyrtare i lëshohet edhe anëtarit të delegacioneve shtetërore të Republikës së Kosovës dhe punëtorëve të organeve tjera shtetërore, kur udhëtojnë zyrtarisht jashtë shtetit, si dhe personave të tjerë të përcaktuar, nëse kjo është në interes të Republikës së Kosovës.

11.3 Pasaportë zyrtare mund ti lëshohet edhe anëtarit të ngushtë të familjes së personit nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse jetojnë me të në bashkësi familjare.

Neni 12

Dokumenti i udhëtimit për kthim, i lëshohet shtetasit të Republikës së Kosovës që ka mbetur pa pasaportë jashtë shtetit, apo i ka skaduar afati i vlefshmërisë së pasaportës.

Neni 13

13.1 Dokumenti i udhëtimit grupor lëshohet për grupin jo më pak se 5 dhe jo më shumë se 50 qytetarë, për një udhëtim në një shtet të caktuar.

13.2 Udhëheqësi i grupit duhet ta ketë pasaportën, ndërsa personat e tjerë që janë të shënuar në listën e udhëtimit duhet të posedojnë ndonjë dokument me fotografi që vërteton identitetin e tyre.

Neni 14

14.1 Dokumentet e udhëtimit lëshohen në formën e përcaktuar nga Ministria kompetente për Punë të Brendshme, në bashkëpunim me Ministrinë kompetente për Punë të Jashtme, si dhe do të përcaktojnë çmimin e dokumenteve të udhëtimit i cili duhet ti paguhet autoritetit kompetent nga shtetasit.

14.2 Dokumenti i udhëtimit –pasaporta përmbanë:

- a) emrin e shtetit të Republikës së Kosovës;
- b) simbolin e shtetit të Republikës së Kosovës;
- c) emrin llojin dhe numrin e dokumentit të udhëtimit;
- d) hapësirën për nënshkrim të zyrtarit të autorizuar prane organit kompetent që e ka lëshuar;
- e) datën e dhënies së dokumentit të udhëtimit;
- f) afatin e vlefshmërisë së dokumenteve të udhëtimit;
- g) hapësirën për nënshkrim të bartësit të dokumentit të udhëtimit;
- h) si dhe të dhënat personale dhe biometrike.

14.3 Formularët e dokumenteve të udhëtimit, formularët për aplikim për dokumente të udhëtimit, formularët për lejen e përfaqësuesve ligjor të referuara në nenin 9 të këtij ligji dhe formularët për lajmërimin e humbjes së dokumenteve të udhëtimit, prodhohen nga ndërmarrja apo organizata e autorizuar, e zgjedhur nga Ministria për Punë të Brendshme, në bashkëpunim me Ministrinë për Punë të Jashtme, në pajtim me dispozitat e ligjit që rregullojnë prokurimin publik.

14.4 Ministria për Punë të Brendshme dhe Ministria për Punë të Jashtme, secila brenda përgjegjësisë të veta, do të kenë të drejtë të ushtrojnë kontroll në ndërmarrjet apo organizatat nga paragrafi 3 i këtij neni, duke inspektuar tërë dokumentacionin përkitazi me procedurat e prodhimit dhe ruajtjes së formularëve të referuar në paragrafin e 3 të këtij neni, vendet ku ato janë prodhuar dhe ruajtur dhe të vërtetojnë se a i përmbushin personat që kryejnë këto detyra kushtet në vijim për kryerjen e detyrave të tilla:

- a) të jenë të moshës madhore ;
- b) nuk kanë vuajtur dënim me burg më tepër se tre muaj për kryerjen e veprës penale, që ndiqet sipas detyrës zyrtare.

14.5 Transportimi i dokumenteve të udhëtimit do të bëhet nga organi kompetent apo organizata e licencuar për transportimin e dërgesave postare në mënyrën që garanton mbrojtjen, sigurinë dhe përcjelljen e dërgesave postare.

Neni 15

Formularët e dokumenteve të udhëtimit shtypen në gjuhët zyrtare dhe në gjuhët zyrtare të komunave të përcaktuara me ligj në alfabetin latin si dhe në gjuhën angleze.

KREU III VLEFSHMËRIA E DOKUMENTEVE TË UDHËTIMIT

Neni 16

16.1 Pasaporta lëshohet me afat vlefshmërie 10 vjeçare.

16.2 Pa marrë parasysh përcaktimet nga paragrafi 1, shtetasit që ende nuk i ka mbushu tre vjet nga dita e lindjes, i lëshohet dokumenti i udhëtimit-pasaporta në afat vlefshmërie prej tre vjetëve, ndërsa për shtetasit e moshës prej tre deri tetëmbëdhjetë vjet pasaporta lëshohet me afat vlefshmërie prej pesë vjetëve.

16.3 Shtetasit, që në periudhën pesë vjeçare humbë, dëmton apo i vjedhin dy apo më shumë pasaporta, i lëshohet pasaporta me afat vlefshmërie prej një viti.

16.4 Dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni nuk zbatohen nëse shtetasi të cilit i është vjedhur pasaporta, ofron prova se ai/ajo është kujdesur për pasaportën dhe ka lajmëruar vjedhjen e pasaportës si vepër penale tek autoritetet kompetente.

Neni 17

Pasaporta diplomatike dhe pasaporta zyrtare, lëshohet për kohën e kryerjes së detyrës, por afati i vlefshmërisë së tyre nuk mund të jetë më shumë se 5 vjet.

Neni 18

Dokumenti i udhëtimit për kthim (fletudhëtimi) lëshohet me afat vlefshmërie që është e nevojshme për kthim në Republikën e Kosovës, respektivisht jo më gjatë se 30 ditë.

Neni 19

Leja e dhënë nga përfaqësuesi ligjor vlen më së shumti një vit pas lëshimit të saj.

Neni 20

20.1 Shtetasi duhet t'i dorëzojë organit kompetent pasaportën më së voni brenda 30 ditëve, nëse:

- a) ndërron emrin apo mbiemrin;
- b) fotografia nuk tregon më pamjen e tij të vërtetë ;
- c) është e dëmtuar, apo për ndonjë arsye tjetër nuk është më për përdorim.
- d) ndërron vendbanimin e përhershëm.

20.2 Në bazë të pikës a, b,c, dhe d të paragrafit 1 të këtij neni, shtetasi mund ta paraqesë kërkesën për tu pajisur me dokument udhëtimi të ri sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 23 të këtij ligji.

Neni 21

21.1 Pa marrë parasysh afatin e vlefshmërisë së dokumenteve të udhëtimit, vlefshmëria e tyre skadon nëse:

- a) paraqitet nga vetë shtetasi se e ka humbur, i është vjedhur, apo i është grabitur,
- b) është dëmtuar nga pakujdesia e mbajtësit të saj.
- c) janë plotësuar fletët për shënim zyrtar;
- d) humb shtetësinë e Republikës së Kosovës;
- e) pushojnë së ekzistuari arsyet për lëshimin e dokumentit të udhëtimit të referuara në nenet 10 dhe 11 të këtij ligji.

21.2 Bartësi duhet t'ia dorëzojë dokumentin e udhëtimit organit kompetent, tetë ditë pas paraqitjes së arsyeve nga paragrafi 1 i këtij neni.

KREU IV PROCEDURA PËR LËSHIMIN E DOKUMENTEVE TË UDHËTIMIT

Neni 22

22.1 Kërkesën për tu pajisur me pasaportë shtetasi e paraqet personalisht pranë organit kompetent.

22.2 Kërkesën mund ta paraqesë shtetasi që i ka mbushur 18 vjet si dhe shtetasi që ende nuk i ka mbushur 18 vjet, por ka fituar zotësinë për të vepruar.

22.3 Për shtetasin më të ri se 18 vjet, respektivisht shtetasi që nuk ka zotësi veprimi, kërkesën e paraqet përfaqësuesi ligjor.

22.4 Pasaporta, fletudhëtimi dhe dokumenti i udhëtimit grupor, jepen me kërkesën e shtetasit, kurse pasaportat diplomatike dhe pasaporta zyrtare jepen me kërkesën e organit kompetent shtetëror.

22.5 Organi kompetent i lëshon paraqitësit të kërkesës dëshmi mbi pranimin e kërkesës.

Neni 23

23.1 Kërkesa për lëshimin e pasaportës bëhet në formularin e caktuar.

23.2 Formulari nga paragrafi 1. i këtij neni përmban këto të dhëna:

- a) emrin personal;
- b) numrin personal të qytetarit;
- a) datën e lindjes;
- b) gjininë;
- c) vendin e lindjes;
- d) vendbanimin e përhershëm ;
- e) shtetësinë;
- f) datën dhe vendin e paraqitjes së kërkesës;
- i) emrin, mbiemrin dhe vendbanimin e përfaqësuesit ligjor;
- j) nënshkrimi i paraqitësit të kërkesës.

23.3 Kërkesës për tu pajisur me pasaportë të re të udhëtimit, përpos në rastet e kërkesës për tu pajisur me fletudhëtimi, shtetasi duhet t'ia bashkëngjisë dokumentin e vjetër të udhëtimit dhe duhet ti merret fotografia me të dhënat biometrike, që tregojnë identitetin e tij të vërtetë.

23.4 Kërkesës për tu pajisur me dokument udhëtimi për kthim, shtetasi duhet ti bashkëngjisë dy fotografi me dimensionet e caktuara, që tregojnë pamjen e tij të vërtetë.

23.5 Në kërkesën për lëshimin e dokumentit të udhëtimit grupor, udhëheqësi i grupit do të caktoj vendin në të cilin udhëton grupi dhe numrin e pasaportës së tij.

23.6 Kërkesës për tu pajisur me dokument udhëtimi diplomatik dhe zyrtar, duhet ti bashkëngjiten edhe të dhënat nga paragrafi 2. i këtij neni, dhe të dhënat mbi titullin dhe funksionin diplomatik respektivisht konzular që kryen personi.

23.7 Pasaporta, pasaporta diplomatike dhe pasaporta zyrtare përmbajnë edhe të dhënat e memorizuara, në të cilat identiteti i bartësit është e ruajtur si e dhënë biometrike sipas standardeve të organizates ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ONAC – ICAO).

Neni 24

24.1 Dokumentet e udhëtimit mund të merren tek organi kompetent apo përmes postës. Mënyrën e dorëzimit e cakton organi kompetent.

24.2 Dorëzimi me postë do të kryhet në momentin kur qytetari e merr dokumentin e udhëtimit. Në rast se qytetari nuk e tërheq dokumentin e udhëtimit brenda tetë ditësh nga marrja e njoftimit mbi dorëzimin postar, dokumenti i udhëtimit do ti kthehet autoritetit kompetent i cili e ka lëshuar atë.

24.3 Shtetasit nga paragrafi 3 i nenit 8 të këtij ligji, dokumenti i udhëtimit i dorëzohet pranë organit të Republikës së Kosovës jashtë shtetit, kompetent për kryerjen e punëve diplomatike konsullore.

Neni 25

25.1 Në raste të humbjes apo vjedhjes së pasaportës, poseduesi duhet menjëherë apo jo më vonë se tetë ditë të lajmërojë policinë përmes formularit, që përmban të dhënat nga pikat a,b,c, të paragrafit 2 të nenit 23 të këtij ligji.

25.2 Për humbjen e dokumentit të udhëtimit jashtë shtetit, shtetasi duhet menjëherë të paraqes, e nëse kjo nuk është e mundur më së voni tetë ditë pas hyrjes në Republikën e Kosovës, të lajmërojë policinë në mënyrën e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

25.3 Në rastin e lajmërimit të humbjes së pasaportës, është e nevojshme të cekën të dhënat e vërteta mbi rrethanat e humbjes së pasaportës.

25.4 Në bazë të paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, pas shpalljes publike të humbjes nga ana e shtetasit, organi kompetent dokumentin e udhëtimit e shpall të pavlefshëm.

25.5 Organi kompetent, me kërkesën e shtetasit, lëshon pasaportën e re, pas shpalljes publike të pavlefshmërisë së pasaportës.

Neni 26

26.1 Lidhur me kërkesën për tu pajisur me pasaportë, organi kompetent duhet të vendosë brenda 15 ditëve pas paraqitjes së kërkesës.

26.2 Shtetasit të cilët janë lindur jashtë Republikës së Kosovës, dhe të cilët nuk janë të regjistruar në librat e të lindurve apo shtetësisë, dhe për të cilët është e domosdoshme të vërtetohet shtetësia dhe të dhënat tjera personale, organi kompetent mund të kërkojë që ata të paraqesin certifikatën e lindjes dhe provën mbi shtetësinë, në të cilin rast periudha brenda së cilës duhet të lëshohet dokumenti i udhëtimit mund të zgjatet për tridhjetë ditë.

26.3 Në rastin, kur organi kompetent dyshon për saktësinë e të dhënave nga neni 25 paragrafi 3 të këtij ligji, afati për lëshimin e dokumentit të udhëtimit mund të shtyhet për kohën e verifikimit të të dhënave, e cila nuk mund të zgjatë më shumë se 60 ditë.

Neni 27

27.1 Organi kompetent, tek i cili ka qenë e paraqitur kërkesa për tu pajisur me pasaportë e refuzon kërkesën në bazë të vendimit të gjykatës nëse :

- a) kundër shtetasit, që ka bërë kërkesën për lëshimin e pasaportës është duke u zhvilluar procedurë penale respektivisht zhvillohet procedura për zgjidhjen e martesës si dhe njohjen e të drejtës prindërore, nëse gjykata kërkon ndalesën e lëshimit të pasaportës ;
- a) ekzistojnë interesat e mbrojtjes së shtetit, të përcaktuara në ligj ;
- b) shtetasit i është shqiptuar së paku dy herë dënimi me burg për veprat penale të prodhimit të kundërligjshëm dhe trafikimit të narkotikëve, falsifikim të parave, kontrabandim, falsifikim të dokumenteve, prodhim kundërligjor dhe trafikim të armëve apo eksplozivëve, kalim të kundërligjshëm të kufirit shtetëror, trafikimit me qenie njerëzore, terrorizmit ndërkombëtar, financimit të veprimtarisë terroriste dhe vepra tjera penale në lidhje me shtetet e huaja,

27.2 Nëse gjykata ka nxjerrë aktgjykim të plotfuqishëm kundër shtetasit të bazuar në pikat a,b,c të paragrafit 1 të këtij neni, duhet të njoftojë organin kompetent mbi refuzimin e kërkesës dhe për këtë duhet të japë arsyetim.

27.3 Nëse ndonjëra nga arsyet nga pikat a,b,c, të paragrafit 1 të këtij neni, është paraqitur pas lëshimit të pasaportës, organi kompetent për dhënien e pasaportës duhet të nxjerri vendim mbi marrjen e pasaportës.

27.4 Ankesa kundër vendimit në bazë të paragrafit 3 të këtij neni, nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.

Neni 28

28.1 Për pushimin e arsyeve për refuzimin e kërkesës për tu pajisur me pasaportë, gjykata kompetente, menjëherë duhet ta lajmërojë organin kompetent.

28.2 Konsiderohet, që nuk ka më arsye për refuzimin e kërkesës për lëshimin e pasaportës nga paragrafi 1 i nenit 27 të këtij ligji, nëse gjykata kompetente, nuk e përtërinë ndalesën.

Neni 29

29.1 Për ankesën kundër vendimit për refuzimin e kërkesës për lëshimin e pasaportës, respektivisht për marrjen e pasaportës, që e ka lëshuar organi kompetent apo misioni diplomatik konsullor, vendos Ministria për Punë të Brendshme.

29.2 Qeveria do të vendosë mbi ankesën e parashtruar kundër vendimit të shkallës së parë të Ministrisë përgjegjëse për Punë të Brendshme për refuzimin e kërkesës për dhënien e pasaportës apo marrjes së pasaportës.

Neni 30

Me kërkesën e shtetasit, të cilit i është refuzuar lëshimi i pasaportës, respektivisht, të cilit i është marrë pasaporta, gjykata që ka kërkuar ndalesën e lëshimit, për arsyet të veçanta (vdekja e anëtarit të ngushtë të familjes, shërimi jashtë shtetit, punët urgjente zyrtare, etj) mund të lejojë lëshimin e pasaportës me afat të kufizuar, jo më të gjatë se 60 ditë.

KREU V

EVIDENCAT

Neni 31

31.1 Organet, që sipas këtij ligji janë kompetente për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit, udhëheqin dhe mbajnë evidencat e posaçme.

31.2 Evidenca përmban këto të dhëna:

- a) llojin e dokumentit të udhëtimit;
- b) datën e lëshimit të dokumentit të udhëtimit;
- c) vlefshmërinë e dokumentit të udhëtimit, dhe lejes se referuar në nenin 9 të këtij ligji;
- d) për numrin serik dhe të regjistrimit të dokumentit të udhëtimit;
- e) për dokumentet e udhëtimit të humbura, dëmtuara dhe të vjedhura;
- f) të dhënat nga neni 9 paragrafi 3 të këtij ligji;
- g) nga neni 23 i këtij ligji; dhe
- h) nga neni 27 i këtij ligji.

31.3 Të dhënat nga evidenca i udhëheq organi kompetent pesë vite pas pushimit të vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit, përveç të dhënave nga neni 27 i këtij ligji, që organi kompetent vepron në pajtim me ligjin për materialin arkivor.

31.4 Organi kompetent do të mbaj evidencën gjithashtu edhe në bazën qendrore të të dhënave të Ministrisë për Punë të Brendshme.

Neni 32

32.1 Të dhënat e përfshira në evidenca do të përdoren, gjatë kryerjes së detyrave nga të punësuarit e Ministrisë për Punë të Brendshme dhe të Ministrisë për Punë të Jashtme, këto të dhëna mund të përdoren edhe nga policia, në rastet kur është e përcaktuar me ligj.

32.2 Pamja e fytyrës së bartësit të dokumentit të udhëtimit, e ruajtur si e dhënë biometrike mund të përdoret vetëm për verifikimin e vërtetësisë së dokumentit të udhëtimit dhe identitetit të bartësit të dokumentit të udhëtimit gjatë kalimit të kufirit shtetëror.

32.3 Të dhënat personale të referuara në nenin 23 mund të përdoren nga ndërmarrja apo organizata e autorizuar nga paragrafi 3 i nenit 14 të këtij ligji, për qëllime të plotësimit me informata të formularëve të dokumenteve të udhëtimit, por këto të dhëna do të shkatërrohen brenda tridhjetë ditësh pas përdorimit të tyre në mbikëqyrjen e Ministrisë për Punë të Brendshme.

KREU VI MBIKËQYRJA

Neni 33

33.1 Mbikëqyrjen mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji e bënë Ministria për Punët e Brendshme dhe Ministria kompetente për Punë të Jashtme, secila brenda përgjegjësisë të veta. Mbikëqyrjen mbi zbatimin e dispozitave të nenit 4 të këtij ligji e bënë edhe policia.

33.2 Ndërmarrja apo organizata nga neni 14 i këtij ligji, është e obliguar që personave të autorizuar nga Ministria për Punë të Brendshme dhe Ministria për Punë të Jashtme, secila brenda përgjegjësisë të veta, tu mundësojnë mbikëqyrjen e hapësirave, ku bëhet prodhimi apo ruajtja e formularëve nga neni 14 i këtij ligji.

33.3 Personi i autorizuar nga paragrafi 2 i këtij neni gjatë kryerjes së mbikëqyrjes ka të drejtë dhe për detyrë të:

- a) urdhërojë, që brenda afatit të caktuar, të mënjanohej pa rregullsitë dhe mangësitë e zbuluara në prodhim, apo deponim të formularëve nga neni 14 i këtij ligji;
- b) urdhërojë ndërprerjen e prodhimit dhe deponimit të formularëve nga neni 14, në qoftë se
- c) gjendet personi i cili nuk i përmbush kushtet nga paragrafi 4 i nenit 14 të këtij ligji;
- d) njoftojë autoritetin kompetent për mbrojtjen e të dhënave personale, nëse konsideron që të
- e) dhënat personale përdoren në kundërshtim me paragrafët 2 dhe 3 të nenit 32 të këtij ligji.

KREU VII DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 34

Me gjobë prej 200 € deri 800 € do të dënohet për kundërvajtje personi :

- a) i cili posedon dokumentin e udhëtimit të vlefshëm dhe e merr tjetrin e llojit të njëjtë (neni 4 i këtij ligji);
- b) i cili shet apo i huazon dokumentin e vetë të udhëtimit tjetrit, respektivisht e blen apo e përdorë dokumentin e udhëtimit të huaj si të vetin apo ndryshon, respektivisht i shlyen të dhënat në dokumentin e udhëtimit, (neni 6 i këtij ligji);
- c) i cili në lajmërimin e humbjes, çek të dhënat jo të vërteta për rrethanat e humbjes së dokumentit të udhëtimit (paragrafi 3 i nenit 25 të këtij ligji) .

Neni 35

35.1 Me gjobë prej 50€ deri 200€ do të dënohet për kundërvajtje personi, i cili:

- a) keqpërdor dokumentin e udhëtimit apo merr dokumentin e huaj të udhëtimit me qëllim të sigurimit të ndonjë përfitimi apo të drejte (neni 6 i këtij ligji);
- b) dokumentin e udhëtimit në afatin e caktuar pas paraqitjes së arsyeve për skadimin e vlefshmërisë së tij, nuk ia dorëzon organit kompetent (sipas paragrafi 2 të nenit 21 të këtij ligji);
- c) dokumentin e udhëtimit nuk ja dorëzon organit kompetent në afatin e caktuar (sipas paragrafit 1 të nenit 20 të këtij ligji).

35.2 Me gjobë prej 300 € deri 1000 € do të dënohet për kundërvajtje personi juridik që e merr dokumentin e udhëtimit të huaj me qëllim të sigurimit të ndonjë përfitimi apo të drejte (sipas nenit 6 të këtij ligji).

35.3 Me gjobë prej 100 € deri 200 € do të dënohet për kundërvajtje edhe personi përgjegjës i personit juridik (paragrafi 2 i nenit 35 të këtij ligji).

KREU VIII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 36

Brenda afatit prej tre muaj, pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, Ministri kompetent për Punë të Brendshme në bashkëpunim me Ministrin kompetent për Punë të Jashtëm, me Udhëzim Administrativ do të përcaktoj:

- a) formën e formularëve nga neni 9, 14, 23 dhe 25 i këtij ligji;
- b) metodën e mbajtjes së evidencave nga nenin 31;
- c) procedurën dhe metodën e prodhimit, lëshimit dhe dorëzimit të dokumentit të udhëtimit, dhënien e lejes së përfaqësuesit ligjor nga nenin 9 dhe shpërndarjen, mbajtjen, përdorimin, kthimin dhe shkatërrimin e të dhënave nga nenit 12;
- d) çmimin e dokumentit të udhëtimit, të cilin shtetasi do të paguaj organit kompetent.

Neni 37

Qeveria e Republikës së Kosovës me propozimin e Ministrisë për Punët e Jashtme, në afatin prej tre muajve, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, cakton kriteret për përcaktimin e interesave të Republikës së Kosovës në bazë të së cilave mund të lëshohet pasaporta diplomatike dhe pasaporta zyrtare..

Neni 38

Dokumentet e udhëtimit të lëshuara nga UNMIK-u, mund të përdoren deri në nxjerrjen e një vendimi të ri për vlefshmërinë e tyre.

Neni 39

Ky ligj shfuqizon të gjitha dispozitat e ligjit të aplikueshëm të cilat janë në kundërshtim me të.

KREU IX HYRJA NE FUQI

Neni 40

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës

Me datën: 20.02.2008